



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Nr. 9094 Prot.

Fier më 10/07/2026

Projekt - Vendim

Nr. 67 Datë 10/07/2026

“Për një shtesë dhe ndryshim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë me Nr.63 datë 23.06.2025, nr.7331/2 prot datë 25.06.2025 “Për miratimin e tabelës me të dhënat e listës emërore të pronave dhe pronarëve që do të shpronësohen për interes publik , për pasuritë e paluajtshme pronë private që preken nga realizimi i projektit “Për vazhdimin e fazës II të Unazës së Cakranit” ,vlerësim paraprak, më qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier , për vijimin e procedurave të shpronësimit për interes publik”

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më dt..../...../2026, i paraqitet për shqyrtim materiali nga ekzekutivi i Bashkisë Fier, në lidhje me një shtesë dhe ndryshim në tabelën format tip me të dhënat e pronave dhe pronarëve pasuritë e paluajtshme të të cilëve preken nga gjurma e shpronësimit për interes publik, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak me Nr.63 datë 23.06.2025, nr.7331/2 prot datë 25.06.2025, përsa i përket shtesës në tabelën tip , të një pasurie të paluajtshme, pronë private dhe ndryshimit të të dhënave të pasurisë së miratuar në tabelën tip me numër rendor 1 (një) .

Në lidhje me këtë shtesë dhe ndryshim në tabelën tip, ekzekutivit i është vënë në dispozicion materiali tekniko-ligjor nga Komisioni i shpronësimit dhe vlerësimit paraprak, mbi bazën e së cilit është bërë procedura administrative-ligjore e vlerësimit paraprak.

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 Pika 1.2, gërma “b”, Ligjin Nr.8561, datë.22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, VKM nr.89, datë 03/02/2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr.138 datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” i ndryshuar, VKM-në nr.216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, shkresën zyrtare nr.6517/2 prot , date 08/06/2026 e Entit Kombëtar të Banesave , Drejtoria Teknike , Tiranë, shkresën datë 19.02.2026 ngarkuar në sistemin e-albania për shërbimin e kërkuar nga Bashkia Fier, “Kthim përgjigje” ASHK, Drejtoria Vendore Fier, shkresën nr.2001/1 prot date 18.03.2026 “Kthim përgjigje” të ASHK Drejtoria Fier, bazuar në nenin 54, gërma “k”, ekzekutivi I Bashkisë :

Propozon:

1-Të miratojë një shtesë dhe ndryshim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë me Nr.63 datë 23.06.2025, nr.7331/2 prot datë 25.06.2025 “Për miratimin e tabelës me të dhënat e listës emërore të pronave dhe pronarëve që do të shpronësohen për interes publik , për pasuritë e paluajtshme pronë private që preken nga realizimi i projektit “Për vazhdimin e fazës II të Unazës së Cakranit” ,vlerësim paraprak, më qëllim mbulimin e vlerës paraprake të

shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier , për vijimin e procedurave të shpronësimit për interes publik”;

2-Tabela e saktësuar, bashkëlidhur këtij vendimi më qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier, ti përcillet Agjencisë Shtetërore Për Shpronësimin , pranë MIE , Tiranë ;

3-Ngarkohet ekzekutivi i Bashkisë Fier për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të shpronësimit për interes publik.

Drejtoria e Hartimit të Projekteve dhe Kontrollit të Punëve Publike

Silvana Basha

Drejtoria e Menaxhimit të Pronave

Mimoza Petushi

Drejtoria Juridike

Esmeralda Kapllanaj

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Sistemit të Adresave, Transportit Publik dhe Sinjalistikës Rrugore

Florjan Troka

Drejtoria e Financës,Buxheti dhe Kontabilitetit

Pranvera Çina

Miratoi
Sekretari i Përgjithshëm
Nikollad Neco

KRYETARI

Armando SUBASHI

